



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2020

PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 09.09.2020)

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 12:09 dhe mbaroi në orën 12:12.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|-----------------------------|--------------------------|
| <i>1. Naureda Llagami</i> | <i>(kryetare)</i> |
| <i>2. Maksim Qoku</i> | <i>(zëvendëskryetar)</i> |
| <i>3. Medi Bici</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>4. Fatmira Luli</i> | <i>(anëtare)</i> |
| <i>5. Brunilda Kadi</i> | <i>(anëtare)</i> |
| <i>6. Dritan Hallunaj</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>7. Ilir Toska</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>8. Alban Toro</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>9. Brikena Ukperaj</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>10. Erjon Muharremaj</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>11. Marçela Shehu</i> | <i>(anëtare)</i> |

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 2. Helena Papa, Drejtore pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë.*

*Mbledhje e Këshillit të Lartë Gjyqësor
Tiranë, më 09.09.2020*

3. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.

4. Pjesë nga stafi administrativ i KLGJ-së.

5. Denisa Varfi, përfaqësuese nga Ministria e Drejtësisë.

6. Përfaqësues të misioneve EURALIUS dhe USAID.

RENDI I DITËS:

1. Shqyrtimi i projektvendimit “Për miratimin e zgjedhjes së tetë gjyqtarëve si anëtarë të Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor”.

Naureda Llagami: Përshëndetje të gjithëve!

Po fillojmë mbledhjen e parashikuar për datën 9 shtator.

Pjesëmarrës janë të gjithë anëtarët e Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Siç jeni në dijeni, sot kemi vetëm një pikë në rendin e ditës, që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për miratimin e zgjedhjes së tetë gjyqtarëve si anëtarë të Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor”.

Siç dhe jeni në dijeni, ditën e djeshme, në rendin e ditës u miratua lista e gjyqtarëve pjesë për shortin për përzgjedhjen e anëtarëve të Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor. Gjithashtu, në prani të përfaqësuesve të partive politike, mediave përfaqësuesve të organizatave joqeveritare, ditën e djeshme, në orën 17:00, në ambientet e Këshillit, u hodh shorti për përzgjedhjen e tetë gjyqtarëve, të cilët do të jenë anëtarë të Kolegjit.

Kodi Zgjedhor, në nenin 146 të tij, përcakton se brenda 24 orëve nga hedhja e shortit, Këshilli i Lartë Gjyqësor miraton me vendim zgjedhjen e gjyqtarëve si anëtarë të Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor.

Pas shortit të ditës së djeshme lista e tetë gjyqtarëve, pjesë e Kolegjit Gjyqësor Zgjedhor është si vijon: {...}; {...}; {...}; {...}; {...}; {...}; {...}; {...}.

Për të kaluar tek a jemi dakord me projekt-aktin e propozuar?

Kalojmë në votim?

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Dakord.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ilir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi: 1. Të miratojë zgjedhjen e tetë anëtarë të Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor, si më poshtë: 1. {...}; 2. {...}; 3. {...}; 4. {...}; 5 {...}; 6. {...}; 7. {...}; 8. {...}.

2. Anëtarët e Kolegjit delegohen në këtë detyrë me një mandat 4-vjeçar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë me publikimin e tij në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Atëherë kjo ishte çështja e mbledhjes.

Në fakt, kisha edhe një çështje tjetër për diskutim.

Siç jeni vënë në dijeni nga e-maili i djeshëm i dërguar nga Komisioni i Disiplinës, Kryetari i Komisionit Disiplinor, për shkak të urgjencës së çështjes, ky Komision i propozon Këshillit një rregullore.

Për shkak se përpara Këshillit është parashtruar një çështje e cila është tashmë në proces, unë do propozoja që ditën e hënë të zhvillojmë një mbledhje të dedikuar për miratimin e kësaj rregulloreje, me qëllim që t'i lejojmë Komisionit më pas për të ndjekur procedurat. Kështu që të hënë do ju njoftojë stafi/administrata për orarin e mbledhjes për rregulloren.

Nëse keni ndonjë gjë?

Nëse jo, atëherë punë të mbarë.

Gjithë të mirat!

* * *

(Mbledhja deklarohet e mbyllur)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor